

VENDIM
Nr. 216, datë 11.3.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E SHPENZIMEVE
ADMINISTRATIVE TË ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR PËR ÇËSHTJEN NR.
ARB/11/24, “MAMIDOIL JETOIL GREEK PETROLEUM PRODUCTS SOCIETE
ANONYME SA KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, të shtohet fondi 125 040 (njëqind e njëzet e pesë mijë e dyzet) dollarë për të përballuar shpenzimet administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen nr. ARB/11/24, “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme SA, kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikeve në Investimet (ICSID).

2. Fondi prej 125 040 (njëqind e njëzet e pesë mijë e dyzet) dollarësh, i konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, t’i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontigjencës.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama